



by Schneider Electric

Manuali i përdorimit për Easy UPS SMV seritë 750, 1000, 1500, 2000, 3000 VA

Mesazhe të rëndësishme për sigurinë

RUANI KËTO UDHËZIME - Kjo pjesë përfshin udhëzime të rëndësishme që duhet të ndiqen gjatë instalimit dhe mirëmbajtjes së pajisjes UPS dhe baterive.

Lexoni me kujdes këto udhëzime dhe shikoni pajisjen për t'u familiarizuar me të para se të përpiqeni ta instaloni, ta përdorni, të kryeni servis ose mirëmbajtje të saj. Mesazhet speciale të mëposhtme mund të shfaqen gjatë gjithë këtij dokumenti ose në pajisje për të paralajmëruar për rreziqe të mundshme ose për të tërhequr vëmendjen për informacione që sqarojnë ose thjeshtojnë një procedurë.



Shtimi i këtij simboli tek etiketa e sigurisë “Rrezik” ose “Paralajmërim” tregon se ekziston një rrezik elektrik që do të shkaktojë lëndime personale nëse nuk ndiqen udhëzimet.



Ky është simboli i sinjalizimit të sigurisë. Ai përdoret për t'ju sinjalizuar për rreziqe të mundshme për lëndime personale. Respektoni të gjitha mesazhet e sigurisë që ndjekin këtë simbol për të shmangur mundësinë për lëndime ose vdekje.

⚠ RREZIK

Etiketa RREZIK tregon një situatë të rrezikshme që, nëse nuk shmanget, do të shkaktojë vdekje ose lëndime serioze.

⚠ PARALAJMËRIM

Etiketa PARALAJMËRIM tregon një situatë të rrezikshme që, nëse nuk shmanget, mund të shkaktojë vdekje ose lëndime serioze.

⚠ KUJDES

Etiketa KUJDES tregon një situatë të rrezikshme që, nëse nuk shmanget, mund të shkaktojë lëndime të vogla ose mesatare.

NJOFTIM

Etiketa NJOFTIM përdoret për t'ju drejtuar praktikave që nuk kanë lidhje me lëndime fizike.

Udhëzimet për lëvizjen e produktit



<18 kg
<40 lb



18-32 kg
40-70 lb



32-55 kg
70-120 lb



>55 kg
>120 lb



Siguria dhe informacione të përgjithshme

Siguria e përgjithshme

- Respektoni të gjitha rregulloret kombëtare dhe lokale për energjinë elektrike.
- Kjo pajisje UPS është e planifikuar vetëm për përdorim në ambiente të brendshme. Për të parandaluar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, instaloheni në një ambient të brendshëm me temperaturë dhe lagështi të kontrolluar, ku nuk ka ndotës përcjellës.
- Prizat elektrike që furnizojnë pajisjen UPS duhet të instalohen pranë njësisë UPS dhe duhet të jenë lehtësisht të arritshme.
- Pajisja UPS duhet të lidhet me një prizë elektrike me togëzim.
- **KUJDES** Kjo pajisje UPS është planifikuar për të përmbushur të gjitha kërkesat vetëm për kompjuterë.
- **KUJDES** Rrezik nga shkarkimet elektrike. Mos e hiqni kapakun e kasës. Servisi duhet të kryhet vetëm nga një inxhinier i kualifikuar.

Siguria e baterisë

KUJDES

GAZ SULFIT HIDROGJENI DHE SHUMË TYM

- Zëvendësoni baterinë të paktën çdo 5 vite.
- Zëvendësoni baterinë menjëherë kur pajisja UPS tregon se zëvendësimi i baterisë është i nevojshëm.
- Zëvendësoni baterinë në fund të jetëgjatësisë së shërbimit.
- Zëvendësoni bateritë me të njëjtin numër dhe lloj baterish siç janë instaluar fillimisht në pajisje.
- Zëvendësoni baterinë menjëherë kur pajisja UPS tregon një situatë mbi temperaturën normale për baterinë ose një nivel mbi temperaturën normale brenda në pajisjen UPS, ose kur ka prova për rrjedhje të elektrolitit. Fikni pajisjen UPS, hiqni prizën nga burimi i rrymës alternative AC dhe shkëputni bateritë. Mos e përdorni pajisjen UPS deri sa t'i keni zëvendësuar bateritë.

Mosrespektimi i këtyre udhëzimeve mund të shkaktojë lëndime.

- Servisi për bateritë e zëvendësueshme duhet të kryhet ose të mbikëqyret nga personeli që ka njohuri për bateritë dhe masat paraprake të nevojshme. Në këtë rast, bateritë nuk mund të zëvendësohen nga përdoruesi.
- Gjatë zëvendësimit të baterive, pajisja UPS duhet të jetë e FIKUR dhe priza e rrymës së alternuar AC duhet të jetë e shkëputur.
- **KUJDES** Mos hidhni bateritë e përdorura në zjarr. Bateritë mund të shpërthejnë.
- **KUJDES** Rrezik shpërthimi nëse bateria zëvendësohet me një lloj të gabuar. Hidhni bateritë e përdorura sipas udhëzimeve.
- Mos i hapni apo deformoni bateritë. Ato përmbajnë një elektrolit që është toksik dhe i dëmshëm për lëkurën dhe sytë.
- **KUJDES** Një bateri mund të paraqesë rrezik nga shkarkimet elektrike dhe rryma e lartë e qarkut të shkurtër. Masat paraprake të mëposhtme duhet të respektohen gjatë punës me bateritë.
 - a. Hiqni orët, unazat ose objektet e tjera metalike.
 - b. Përdorni veglat me doreza të izoluar.
 - c. Vishni doreza dhe çizme prej gome.
 - d. Mos vendosni vegla ose pjesë metalike mbi bateritë.
 - e. Shkëputni burimin e karikimit para lidhjes ose shkëputjes së terminaleve të baterisë.
 - f. Përcaktoni nëse bateria është e lidhur aksidentalisht me togëzimin. Nëse është e lidhur aksidentalisht me togëzimin, hiqni burimin nga togëzimi. Kontakti me çdo pjesë të një baterie me togëzim mund të shkaktojë goditje elektrike. Mundësia për goditje të tilla mund të zvogëlohet nëse togëzime të tilla hiqen gjatë instalimit dhe mirëmbajtjes.

- **KUJDES** Pajisja UPS përmban bateri të brendshme dhe mund të përbëjë një rrezik për goditje edhe kur e shkëputni atë nga rryma e alternuar AC.
- **KUJDES** Rrezik për goditje elektrike. Qarku i baterisë nuk është i izoluar nga hyrja e rrymës së alternuar AC. Mes terminaleve të baterisë dhe togëzimit mund të ketë voltazh të rrezikshëm. Testojeni para se ta prekni.

Paralajmërimi për radiofrekuencat

Ky është një produkt UPS i kategorisë C2. Në një ambient banimi, ky produkt mund të shkaktojë ndërhyrje të radiofrekuencave dhe në një rast të tillë përdoruesit mund t'i nevojitet të marrë masa shtesë.

Lista e artikujve



Kabloja USB



Softueri, dokumentacioni i përdoruesit

Opsionale

Modeli	Kabloja
SMV750CAI	a x 1 b x 1
SMV1000CAI	
SMV1500CAI	
SMV2000CAI	
SMV3000CAI	a x 1 c x 1



a) Spina IEC C14 me prizë C13



b) Spina SCHUKO me prizë IEC C13



c) Spina SCHUKO me prizë IEC C19

Veçoritë e produktit

- A

Butoni i ndezjes/fikjes

B

RS-232

C

Porta USB

D

Vrima e ventilatorit/ajrimit

E

Bashkuesi i baterisë

F

Hyrja e rrymës së alternuar AC
- G

Siguresa

H

Prizat rezervë të baterisë me mbrojtje nga tensioni i lartë

I


Çelës ndërprerës për daljen (vetëm për SMV3000CAI)


J

Foleja inteligjente


K

Kontakti i thatë


Modeli	Lloji i daljes dhe sasia
SMV750CAI SMV1000CAI SMV1500CAI	 x 6




Modeli	Lloji i daljes dhe sasia
SMV2000CAI	 x 6



Modeli	Lloji i daljes dhe sasia
SMV3000CAI	 x 6



Ekrani i panelit të përparmë

LCD	Statusi
	<div>1. Modaliteti në linjë</div> <div>2. Modaliteti i baterisë</div> <div>3. Rregullimi automatik i voltazhit</div> <div>4. Kapaciteti i baterisë</div> <div>5. Kapaciteti i ngarkesës</div> <div>6. Statusi i pajisjes UPS</div> <div>7. Butoni i ndezjes/fikjes</div>

Instalimi dhe ndezja

1. Instalimi.

- Pajisja UPS DUHET të instalohet në ambiente të brendshme dhe të kontrolluara, pa pluhur të tepërt, ajër gërryes ose pluhur përcjellës.
- MOS e instaloni në ambiente të jashtme.
- Mbani larg nga drita e diellit, uji dhe burimet e nxehtësisë.
- Vendosni njësinë në një dyshe me qëndrueshme.



2. Lidhni baterinë duke tërhequr lart dorezën e baterisë dhe më pas duke e shtytur në njësi.

- Bashkuesi i baterisë ndodhet në panelin e pasmë.
 - Lidhni para përdorimit.
 - Shkëputeni para transportit. Fikni pajisjen UPS dhe hiqni kabllo elektrikë hyrës para se të shkëputni bashkuesin e baterisë.



3. Lidhni pajisjen me UPS-in. Shmangni përdorimin e kabllave zgjatuese.

- MOS lidhni printerë, ngrohës ose fotokopje me pajisjen UPS.
- Gjatë ndërprerjes së rrymës elektrike ose problemeve të tjera të rrymës së alternuar AC, daljet e rezervës së baterisë marrin energji nga Easy UPS për një kohë të kufizuar.

4. Vendosni kordonin elektrik të pajisjes Easy UPS drejtpërdrejt në një prizë në mur, jo në një pajisje mbrojtëse mbtensiononi apo një zgjatues me shumë priza.

5. Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për të ndezur njësinë.


- Pajisja Easy UPS duhet të karikojë baterinë për të paktën 8 orë për të siguruar një funksionim të mjaftueshëm.
- Gjatë shtypjes së rrymës elektrike për 1~3 sekonda. Tingulli sinjalizues konfirmon se pajisja Easy UPS është e ndezur dhe siguron energji nga prizat dalëse.

6. Kryeni ndezjen e ftohtë të pajisjes UPS.

- Përdorni veçorinë e ndezjes së ftohtë për të furnizuar pajisjen e lidhur me energji nga bateritë e njësisë UPS kur njësisë UPS është e fiksuar dhe nuk ka një shërbim elektrik.

7. Lidhni dhe instaloni softuerin e menaxhimit.


- Pajisja Easy UPS është e pajisur me softuer menaxhimi për fikjen e sistemit operativ të pambikëqyrur, monitorimin e UPS-së dhe parametrat e UPS-së.
- Referojuni www.apc.com për më shumë informacione.



8. Kur pajisja UPS funksionon në një nga tre situatat e shfaqura më poshtë, do të aktivizohet ndërfaqja e kontaktit të thatë. Diagrami shfaqet në Figurën 1.

- Kur pajisja UPS identifikon një defekt të baterisë, do të aktivizohet porta PIN1-4 për kontaktin e thatë.
- Kur pajisja UPS punon në modalitetin e rezervës, do të aktivizohet porta PIN2-4 për kontaktin e thatë.
- Kur pajisja UPS punon në modalitetin e rrymës së alternuar AC, do të aktivizohet porta PIN3-4 për kontaktin e thatë.

Kur pajisja UPS punon në...	Aktivizohet
1. Modaliteti i rrymës së alternuar AC	PIN3-4
2. Modaliteti i rezervës	PIN2-4
3. Modaliteti i gatishmërisë	Nuk gjen zbatim
4. Modaliteti i rrymës së alternuar AC dhe bateri e dobët	PIN1-4 dhe PIN3-4
5. Modaliteti i gatishmërisë dhe bateria e dobët	PIN1-4









(Fig. 1)

Specifikimet

Modeli		SMV750CAI	SMV1000CAI	SMV1500CAI	SMV2000CAI	SMV3000CAI
Hyrja	Voltazhi	220/230/240VAC				
	Gama e voltazhit	165~290Vac±5Vac			165~295Vac±8Vac	
	Siguresa	8A	8A	12A	20A	25A
	Gama e frekuencës	45-65 Hz (ndjeshmëria automatike) ±1Hz				
Dalja	Kapaciteti i pajisjes UPS (total)	750VA 525W	1000VA 700W	1500VA 1050W	2000VA 1400W	3000VA 2100W
	Voltazhi nominal	230VAC				
	Koha e transferimit	Tipike 2-6 ms, 12 ms maks.				
	Forma e valës	Valë sinusoidale e pastër				
Bateria	Tipi (pa mirëmbajtje)	12V/7Ah x 2 plumb-acid	12V/7Ah x 2 plumb-acid	12V/10Ah x 2 plumb-acid	12V/7Ah x 4 plumb-acid	12V/9Ah x 4 plumb-acid
	Koha e karikimit	4-6 rikuperimi në kapacitet 90%				
Fizike	Përmasat (The x Gje x La, mm)	410 x 160 x 220			455 x 180 x 240	
	Pesha neto (kg)	13,6		17,8	23,5	25,2
	Përmasat e paketimit (The x Gje x La, mm)	508 x 272 x 339			604 x 319 x 414	
	Pesha bruto (kg)	16,6		20,75	26,9	28,9
Ambienti	Temperatura dhe lagështia operative	0-95 % lagështi relative RH @ 0-40°C (pa kondensim)				
	Niveli i zhurmës	Më pak se 45 dB				
Tipi i kasës	Vlerësimi IP	IP20				

Treguesit zanorë dhe lkonat e statusit

Nëse pajisja Easy UPS...	Shkaku i mundshëm...
Lëshon sinjale "bip" çdo 2 sekonda.	Easy UPS po punon me bateri. Duhet të kini parasysh se duhet të ruani çdo punë në vazhdim.
Sinjale "bip" në vazhdimësi.	Situatë e nivelit të ulët të baterisë dhe koha e punës së baterisë është shumë e vogël. Ruani menjëherë çdo punë në vazhdim, dilni nga të gjitha aplikacionet e hapura dhe fikeni sistemin operativ.
Toni i vazhdueshëm me  me ndriçim.	Daljet e rezervës së baterisë kanë mbingarkesë.
Toni i vazhdueshëm me  me ndriçim. a. Shtypni butonin e ndezjes/fikjes për 1-3 sekonda për ta çaktivizuar alarmin b. Toni i vazhdueshëm do të vijojë deri sa bateria të jetë në nivel të ulët. (<11 Vdc për çdo bateri)	 01 : Është zbuluar një defekt i ventilatorit  02 : Qark i shkurtër i inverterit  03 : Mbitension i inverterit
Lëshon sinjale "bip" çdo 4 sekonda me  me ndriçim.	Bateria është afër fundit të jetëgjatësisë së dobishme ose është e dëmtuar.

Zgjidhja e problemeve

Problemi dhe shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Pajisja Easy UPS nuk ndizet	
Pajisja Easy UPS nuk është ndezur.	Shtypni butonin e ndezjes/fikjes.
Pajisja Easy UPS nuk është lidhur me rrymën e alternuar AC, nuk ka rrymë të alternuar AC nga priza e murit ose rryma e alternuar AC është në një situatë të rënies së tensionit ose të mbitensionit.	Sigurohuni që kordoni elektrik të jetë lidhur në mënyrë të sigurt me prizën e murit dhe që të ketë rrymë të alternuar AC në prizën e murit. Kur është e zbatueshme, kontrolloni që priza e murit të jetë e ndezur ose që siguresa e hyrjes punon si duhet.
Bateria është e shkëputur.	Referojuni <i>Vendit dhe fuqisë në faqen 5</i> .
Pajisja e lidhur humbet fuqi	
Pajisja Easy UPS është në një situatë mbitensionit.	Hiqni nga prizat dalëse të gjitha pajisjet që nuk janë thelbësore. Lidhni përsëri pajisjet një nga një me njësinë Easy UPS.
Bateria e pajisjes Easy UPS është plotësisht e shkarkuar.	Lidhni pajisjen Easy UPS me rrymën e alternuar AC dhe rikarikojeni për 10 orë.
Pajisja Easy UPS mund të ketë nevojë për shërbim.	Kontakttoni Ekipin e ndihmës teknike të Schneider Electric.
Pajisja Easy UPS punon me energjinë e baterisë, ndërkohë që është e lidhur me rrymën e alternuar AC	
Spina ka dalë pjesërisht nga priza e murit, priza e murit nuk merr më rrymë të alternuar AC ose siguresa është djegur.	Sigurohuni që spina të jetë futur plotësisht në prizën e murit. Sigurohuni që priza e murit merr rrymë të alternuar AC duke e kontrolluar atë me një pajisje tjetër. Ose zëvendësoni siguresën.
Mesazhi Err ndriçon në ndërfaqen e ekranit	
Err 01 : Është zbuluar një defekt i ventilatorit	Fikni pajisjen Easy UPS. Pastroni pluhurat ose materialet e huaja që bllokojnë ventilatorin e ftohjes dhe ndizni pajisjen Easy UPS. Nëse mesazhi i gabimit vazhdon të shfaqet, kontakttoni Ekipin e ndihmës teknike të Schneider Electric.
Err 02 : Është zbuluar një qark i shkurtër i inverterit	Fikni pajisjen Easy UPS. Shkëputni pajisjet që nuk janë thelbësore nga prizat dhe ndizni pajisjen Easy UPS. Nëse mesazhi i gabimit vazhdon të shfaqet, kontakttoni Ekipin e ndihmës teknike të Schneider Electric.
Err 03 : Është zbuluar mbitension i inverterit	Kontakttoni Ekipin e ndihmës teknike të Schneider Electric.
Pajisja Easy UPS lëshon sinjale "bip" çdo 4 sekonda	
Bateria është e shkëputur.	Sigurohuni që bashkuesi i baterisë në panelin e pasmë është i lidhur.
Bateria është afër fundit të jetëgjatësisë së dobishme ose është e dëmtuar.	Kontakttoni Ekipin e ndihmës teknike të Schneider Electric nëse pajisja Easy UPS vazhdon të lëshojë sinjale "bip" kur bashkuesi i baterisë është lidhur në mënyrë të sigurt.
Pajisja Easy UPS ka një kohëzgjatje pune të papërshtatshme të baterisë	
Bateria nuk është karikuar plotësisht. Bateria është afër fundit të jetëgjatësisë së dobishme dhe duhet të zëvendësohet.	Lëreni pajisjen Easy UPS të lidhur me rrymën e alternuar AC për 10 orë ndërkohë që bateria karikohet në kapacitetin e saj të plotë. Me kalimin e kohës në përdorim, kohëzgjatja e punës së baterisë zvogëlohet.

Servisi

Nëse njëësia ka nevojë për servis, mos e ktheni atë te shitësi. Ndiqni këto hapa:

1. Rishikoni pjesën për Zgjidhjen e problemeve në manual për të eliminuar problemet e zakonshme.
2. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni Ekipin e ndihmës teknike të Schneider Electric IT (SEIT) nëpërmjet faqes së internetit të APC by Schneider Electric, **www.apc.com**.
 - a. Kini parasysh numrin e modelit dhe numrin e serisë, si dhe datën e blerjes. Numrat e modelit dhe të serisë ndodhen në panelin e pasmë të njësisë.
 - b. Telefononi Ekipin e mbështetjes së klientit të SEIT dhe një teknik do të përpiqet ta zgjidhë problemin nëpërmjet telefonit. Nëse kjo nuk është e mundur, tekniku do të nxjerrë një Numër autorizimi për materialin e kthyer (RMA#).
 - c. Nëse njëësia është brenda garancisë, riparimet janë falas.
 - d. Procedurat e servisit dhe kthimet mund të ndryshojnë në nivel ndërkombëtar. Referojuni faqes së internetit të APC by Schneider Electric për udhëzime specifike sipas shtetit.
3. Paketoni njësinë në paketimin original kur është e mundur për të shmangur dëmtimin gjatë transportit. Mos përdorni asnjëherë kokrriza shkume për paketimin. Dëmtimet e pësura gjatë transportit nuk mbulohen nga garancia.
4. **SHKËPUTNI GJITHMONË BATERITË E PAJISJES UPS para transportit. Rregulloret e Departamentit të Transportit të Shteteve të Bashkuara (DOT) dhe Shoqatës Ndërkombëtare të Transportit Ajror (IATA) kërkojnë që bateritë UPS të shkëputen para transportit. Bateritë e brendshme mund të qëndrojnë në pajisjen UPS.**
5. Shkruani numrin RMA# të dhënë nga Ekipi i mbështetjes së klientit në pjesën e jashtme të paketimit.
6. Ktheni njësinë me postë të siguruar dhe parapagesë në adresën e dhënë nga Ekipi i mbështetjes së klientit.

Garancia

Regjistroni produktin tuaj në internet <http://warranty.apc.com>

Garancia standarde është dy (2) vite nga data e blerjes. Procedura standarde e kompanisë SEIT është zëvendësimi i njësisë origjinale me një njësi të rikushtëzuar në fabrikë. Klientët që duhet të marrin përsëri njësinë origjinale për shkak të caktimit të etiketave të asetëve dhe planeve të caktuara të amortizimit duhet të deklarojnë një kërkesë të tillë në kontaktin e tyre të parë me një përfaqësues së Ekipit të ndihmës teknike të kompanisë SEIT. Kompania SEIT do ta dërgojë njësinë zëvendësuese pasi njëësia me defekt të jetë marrë nga departamenti i riparimit, ose mund të kryejë transportin në të njëjtën kohë pas marrjes së një numri të një karte krediti të vlefshme. Klienti paguan për transportin e njësisë për te kompania SEIT. Kompania SEIT paguan kostot e transportit rrugor të mallrave në lidhje me transportin e njësisë zëvendësuese për te klienti.

Ekipi i mbështetjes së klientit i APC by Schneider Electric IT në të gjithë botën

Për mbështetje specifike sipas shtetit për klientit, shkoni te faqja e internetit e APC by Schneider Electric, **www.apc.com**.